



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

Data	
Nr. Prot	

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. FATLIND BUJAR SOKOLAJ, KANDIDAT PËR ANËTAR NË
KËSHILLIN E BASHKISË TROPOJË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA
DEMOKRATIKE"

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 10000 unik. KQZ bëri verifikimin "*prima facie*" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Fatlind Bujar Sokolaj, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitetet të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjenealitetet e tij.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, Pa dokumentacion Ligjor, ndaluar në Gjenevë, Zvicër.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka qëndruar tek të afërmit si vizitor në Hanover të Gjermanisë për periudhën Shkurt deri në Prill të vitit 2018.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4087 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 614/31 prot., datë 04.10.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Fatlind Bujar Sokolaj. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo ndryshime nga ato të deklaruara;

- Rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë, nga autoritetet e drejtësisë në Konfederatën e Zvicrës, më datë 18.10.2022, për veprën të *“Shkelje e ligjit mbi lëndët narkotike”*, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b” i ligjit Federal Zvicerian për lëndët narkotike qe referuar Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikohet nga neni 283/1 i Kodit Penal ku parashikohet; Prodhimi dhe shitja e narkotikëve “Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në cdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përvec rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”;
- Rezulton të ketë qenë në hetim/gjykim në Konfederatën e Zvicrës, për të cilin është regjistruar procedimi penal – Nr.Dosje:P/21931, për veprën penale të *“Shkeljes e ligjit mbi lëndët narkotike, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b”*;
- Rezulton të ketë qenë “i arrestuar” nga organet ligjzbatuese në konfederatën e Zvicrës, për kryerje e veprës penale *“Shkeljes e ligjit mbi lëndët narkotike, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b”*. Datë arrestimi 17.10.2022
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë regjistruar procedimi penal;
- Nuk rezulton të ketë qenë i *arrestuar/ndaluar* nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton t’i jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj këtij personi *urdhër kërkimi ndërkombëtar* lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Rezulton që ndaj tij të jetë marrë masa e “dëbimit” nga Konfederata e Zvicrës, për arsye se qëndrimi i tij në këtë shtet përbën: Kërcënim për sigurinë dhe rendin publik, si dhe marrëdhëniet ndërkombetare të Zvicrës; Data e dëbimit: 18.10.2022. Ndalim Hyrje ndaj Fatlind Sokolaj, e vlefshme deri më 28 nëntor 2027.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat i listës shumemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” për Këshillin Bashkisë Tropojë, Qarku Kukës, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë asnjë mandat në Këshillin Bashkiak. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike, referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në bashkinë Tropojë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumemërore të Partisë Demokratike, nuk do të mund të përfitojë mandat në Këshillin e Bashkisë Tropojë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat në këshill, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. FATLIND BUJAR SOKOLAJ, KANDIDAT PËR ANËTAR NË
KËSHILLIN E BASHKISË TROPOJË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA
DEMOKRATIKE"**

Sot më datë 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të interesuara: Z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Data: 2023 Nr:
Ora:



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 10000 unik. KQZ bëri verifikimin "prima facie" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Fatlind Bujar Sokolaj rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjenealitetet të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjenealitetet e tij.
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet / huaj ?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO",
 - Pa dokumentacion Ligjor, ndaluar ne Gjenevë, Zvicër.

Data: 2023 Nr:
Ora:



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

- **Pyetjes 8** “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka qëndruar tek të afërmit si vizitor në Hanover të Gjermanisë për periudhën Shkurt deri në Prill të vitit 2018.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4087 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 614/31 prot., datë 04.10.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Fatlind Bujar Sokolaj. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo ndryshime nga ato të deklaruara;
- Rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë, nga autoritetet e drejtësisë në Konfederatën e Zvicrës, më datë 18.10.2022, për veprën të “Shkelje e ligjit mbi lëndët narkotike”, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b” i ligjit Federal Zvicerian për lëndët narkotike që referuar Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikohet nga neni 283/1 i Kodit Penal ku parashikohet, Prodhimi dhe shitja e narkotikëve “Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përvec rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”;
- Rezulton të ketë qenë në hetim/gjykim në Konfederatën e Zvicrës, për të cilin është regjistruar procedimi penal – Nr.Dosje:P/21931, për veprën penale të “Shkeljes e ligjit mbi lëndët narkotike, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b”;
- Rezulton të ketë qenë “i arrestuar” nga organet ligjzbatuese në konfederatën e Zvicrës, për kryerjen e veprës penale “Shkeljes e ligjit mbi lëndët narkotike, Neni 19, paragrafi 1, shkronja b”. Datë arrestimi 17.10.2022.

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”

- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë regjistruar procedimi penal;
- Nuk rezulton të ketë qenë i *arrestuar/ndaluar* nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj këtij personi *urdhër kërkimi ndërkombëtar* lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Rezulton që ndaj tij të jetë marrë masa e “dëbimit” nga Konfederata e Zvicrës, për arsye se qëndrimi i tij në këtë shtet përbën: Kërcënim për sigurinë dhe rendin publik, si dhe marrëdhëniet ndërkombetare të Zvicrës; Data e dëbimit: 18.10.2022. Ndalim Hyrje ndaj Fatlind Sokolaj, e vlefshme deri më 28 nëntor 2027.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealogjet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat i listës shumemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” për Këshillin Bashkisë Tropojë, Qarku Kukës, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë asnjë mandat në Këshillin Bashkiak. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike, referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në bashkinë Tropojë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumemërore të Partisë Demokratike, nuk do të mund të përfitojë mandat në Këshillin e Bashkisë Tropojë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat në këshill, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objektin dhe qëllimin e procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Fatlind Bujar Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”